


PBB sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, 2015

Tiranë, 31 Korrik, 2017: Në vitin 2015, sipas rajoneve statistike në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korente është 1.427.799 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 2,23 %, krahasuar me vitin 2014.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2015, e ka dhënë Qarku Tiranë me +2,1 pikë përqindje, pasuar nga Qarku Durrës me + 0,76 pikë përqindje dhe Qarku Dibër me +0,36 pikë përqindje.

Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë Qarku Fier me -0,81 pikë përqindje, i pasuar me Qarkun Elbasan me një kontribut prej -0,21 pikë përqindje dhe Qarkun Gjirokastrë me një kontribut prej -0,15 pikë përqindje.

Fig.1 Kontributi i Qarqeve në rritjen ekonomike



Për publikim 31/07/2017

Në vitin 2015, sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin Qendër, PBB me çmime korente ishte 671,0 miliardë lekë ose 47,0 %, ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2014, për rajonin Qendër, PBB në terma reale shënoi një rritje prej 4,2 %.

PBB me çmime korente në rajonin Jug ishte 420,1 miliardë lekë ose 29,4 %, ndaj totalit të vendit. Krahasuar me vitin 2014, në rajonin Jug, PBB në terma reale shënoi një rënie me 2,8 %.

PBB me çmime korente në rajonin Veri ishte 336,6 miliardë lekë ose 23,6 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2014, PBB në terma reale në rajonin Veri shënoi një rritje prej 5,3 %. Sipas rajoneve statistikore në nivel 3, rritjen më të lartë e shënoi Qarku Dibër me 11,5 %, në terma realë, i ndjekur nga Qarku Durrës me 8,2 % dhe Qarku Tiranë me 5,5 %.

Rritja ekonomike u ngadalësua në Qarkun Fier, duke shënuar rënie në terma realë prej 6,0 %, pasuar me Qarkun Gjirokastrë, PBB e të cilit ra me 5,7 % dhe në Qarkun Kukës me një rënie në terma realë prej 5,6 %.

Tab. 1 PBB sipas rajoneve statistikore

Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	PBB çmime korente (milion lekë)	PBB çmime korente (milion lekë)	Rritja Reale e PBB-së	Kontributi ndaj rritjes Reale	Struktura ndaj PBB-së	Struktura ndaj PBB-së
		2014	2015*	2015/2014	2015/2014	2014	2015*
AL	Republika e Shqipërisë	1.395.305	1.427.799	2,23	2,23	100,0	100,0
AL01	Veri	320.594	336.634	5,30	1,22	23,0	23,6
AL011	Dibër	44.031	47.170	11,52	0,36	3,2	3,3
AL012	Durrës	129.149	138.616	8,19	0,76	9,3	9,7
AL013	Kukës	27.176	26.092	-5,65	-0,11	1,9	1,8
AL014	Lezhë	46.666	47.328	0,91	0,03	3,3	3,3
AL015	Shkodër	73.573	77.428	3,34	0,18	5,3	5,4
AL02	Qendër	634.776	671.019	4,15	1,89	45,5	47,0
AL021	Elbasan	103.357	101.502	-2,84	-0,21	7,4	7,1
AL022	Tiranë	531.419	569.517	5,51	2,10	38,1	39,9
AL03	Jug	439.935	420.147	-2,79	-0,88	31,5	29,4
AL031	Berat	52.676	54.349	1,75	0,07	3,8	3,8
AL032	Fier	188.760	168.641	-6,00	-0,81	13,5	11,8
AL033	Gjirokastrë	36.269	34.569	-5,66	-0,15	2,6	2,4
AL034	Korçë	80.261	81.504	1,09	0,06	5,8	5,7
AL035	Vlorë	81.970	81.084	-0,82	-0,05	5,9	5,7

*Vlerësimi për vitin 2015 bazohet në të dhëna gjysmë finale

PBB për frymë sipas niveleve statistikore

Në vitin 2015 niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 është rreth 496 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2014 PBB për frymë u rrit me 2,63 %.


Në rajonin statistikor Qendër, PBB për frymë është 595 mijë lekë dhe pati një rritje me 4,8 %, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij rajoni rezultoi 20,1 % mbi mesataren e vendit. Në rajonin statistikor Veri, PBB për frymë është 404 mijë lekë, duke shënuar një rritje me 5,9 %, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij rajoni është 18,5 % nën mesataren e vendit.

Në rajonin statistikor Jug, PBB për frymë është 457 mijë lekë, duke shënuar një rënie me 3,3 %, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij rajoni është 7,8 % nën mesataren e vendit.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3, në vitin 2015, është Qarku Tiranë me 679 mijë lekë dhe pati një rritje me 5,5 %, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij qarku është 37,0 % mbi mesataren e vendit. Më pas renditen Qarku Fier me 550 mijë lekë, duke shënuar një rënie prej 9,6 %, ndaj vitit 2014. PBB për frymë e këtij qarku është 11,0 % mbi mesataren e vendit.

PBB për frymë për qarqet e tjera është nën mesataren e vendit, ku më e ulta është ajo e Qarkut Kukës me rreth 319 mijë lekë duke shënuar një rënie me 2,2 %, krahasuar me vitin 2014. PBB për frymë e këtij qarku është 35,7 % nën mesataren e vendit. Më pas, me PBB-në për frymë më të ulët, renditet Qarku Elbasan me rreth 351 mijë lekë duke shënuar një rënie me 0,5 % ndaj vitit 2014. PBB për frymë e këtij qarku është 29,2 %, nën mesataren e vendit.

Fig.2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2015 (000/lekë)



Tab. 2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore

Kodi	Niveli Statistikor 2/3	PBB për frymë (lekë)	PBB për frymë (lekë)	Indeksi ndaj PBB-së (%)	
				AI=100	AI=100
		2014	2015*	2014	2015*
AL	Republika e Shqipërisë	482.954	495.643	100	100
AL01	Veri	381.348	403.774	79,0	81,5
AL011	Dibër	331.821	362.688	68,7	73,2
AL012	Durrës	466.201	496.660	96,5	100,2
AL013	Kukës	325.978	318.730	67,5	64,3
AL014	Lezhë	351.431	361.160	72,8	72,9
AL015	Shkodër	342.496	365.815	70,9	73,8
AL02	Qendër	567.782	595.030	117,6	120,1
AL021	Elbasan	352.991	351.050	73,1	70,8
AL022	Tiranë	643.997	679.154	133,3	137,0
AL03	Jug	472.832	457.039	97,9	92,2
AL031	Berat	376.954	396.984	78,1	80,1
AL032	Fier	608.644	550.106	126,0	111,0
AL033	Gjirokastrë	513.990	502.540	106,4	101,4
AL034	Korçë	362.167	372.488	75,0	75,2
AL035	Vlorë	435.137	430.800	90,1	86,9

*Vlerësimi për vitin 2015 bazohet në të dhëna gjysmë finale

Standardi i Fuqisë Blerëse

PBB e Republikës së Shqipërisë e shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard - PPS) në vitin 2015 është 24.604 PPS ose 29,6 %, e mesatares së Bashkimit Evropian BE28 = 100 (shih shënime metodologjike). Sipas rajoneve statistikore niveli 2 në rajonin Qendër, PBB për frymë në PPS për vitin 2015 është 35,5 %, në rajonin Veri 24,1 % dhe në rajonin Jug 27,4 %.

Kodi	Rajonet Statistikore	PBB për frymë në PPS (BE28=100) në 2015
	Republika e Shqipërisë	29,6
	Rajone Statistikore Nivel 2	
AL01	Veri	24,1
AL02	Qendër	35,5
AL03	Jug	27,4

*Vlerësimi për vitin 2015 bazohet në të dhëna gjysmë finale

Tab. 3 Struktura e Rajoneve Statistikore sipas degëve të ekonomisë (Dega = 100%), viti 2015*

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivite të pasurive të paluajtshme	Aktivite shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
AL	Republika e Shqipërisë	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
AL01	Veri	29,4	26,5	22,5	22,5	14,1	16,3	24,5	14,3	22,3	15,1	23,6
AL011	Dibër	6,3	5,2	1,4	1,3	1,7	1,8	1,5	0,6	3,8	0,7	3,3
AL012	Durrës	7,7	11,6	11,4	13,1	6,4	5,6	13,7	7,6	6,4	6,6	9,7
AL013	Kukës	3,3	1,7	1,0	1,0	1,5	1,3	1,0	0,3	2,7	0,8	1,8
AL014	Lezhë	4,6	2,1	3,9	2,7	2,0	3,5	3,1	2,9	3,5	2,8	3,3
AL015	Shkodër	7,4	6,0	4,7	4,5	2,5	4,1	5,1	2,9	5,9	4,2	5,4
AL02	Qendër	20,7	39,5	56,4	54,7	70,3	59,8	53,2	75,5	53,4	66,6	47,0
L021	Elbasan	12,4	7,4	4,1	5,8	4,0	4,9	5,5	1,7	7,1	4,2	7,1
AL022	Tiranë	8,3	32,1	52,3	48,9	66,3	54,9	47,7	73,7	46,3	62,4	39,9
AL03	Jug	49,9	34,0	21,1	22,8	15,6	23,9	22,3	10,2	24,4	18,3	29,4
AL031	Berat	8,5	3,1	2,1	2,4	2,2	1,9	1,9	0,6	3,4	2,2	3,8
AL032	Fier	21,4	20,3	6,1	7,4	4,8	7,9	7,0	4,8	6,5	4,7	11,8
AL033	Gjrokastrë	3,3	1,4	2,0	2,8	2,1	3,0	1,6	0,8	2,9	2,3	2,4
AL034	Korçë	10,5	3,6	4,6	4,4	3,2	5,4	4,4	1,5	5,8	5,0	5,7
AL035	Vlorë	6,2	5,6	6,3	5,9	3,3	5,6	7,4	2,6	5,7	4,0	5,7


*Vlerësimi për vitin 2015 bazohet në të dhëna gjysëm finale

Tab. 4 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Rajoni=100%), viti 2015*

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
AL	Republika e Shqipërisë	22,9	13,9	10,2	18,1	3,26	3,11	6,83	6,28	12,64	2,76	100,0
AL01	Veri	28,5	15,7	9,8	17,3	1,9	2,2	7,1	3,8	11,9	1,8	100,0
AL011	Dibër	43,9	21,8	4,4	7,0	1,7	1,7	3,2	1,2	14,5	0,6	100,0
AL012	Durrës	18,2	16,7	12,0	24,4	2,1	1,8	9,7	4,9	8,4	1,9	100,0
AL013	Kukës	41,0	13,2	5,7	10,4	2,7	2,2	3,8	1,2	18,7	1,2	100,0
AL014	Lezhë	32,0	8,6	12,2	14,5	2,0	3,3	6,4	5,4	13,3	2,3	100,0
AL015	Shkodër	31,4	15,4	8,9	14,9	1,5	2,4	6,4	3,3	13,7	2,1	100,0
AL02	Qendër	10,1	11,7	12,3	21,0	4,9	4,0	7,7	10,1	14,4	3,9	100,0
AL021	Elbasan	39,9	14,5	5,9	14,7	1,8	2,1	5,3	1,5	12,5	1,6	100,0
AL022	Tiranë	4,7	11,2	13,4	22,2	5,4	4,3	8,2	11,6	14,7	4,3	100,0
AL03	Jug	38,7	16,1	7,3	14,0	1,7	2,5	5,2	2,2	10,5	1,7	100,0
AL031	Berat	51,1	11,2	5,8	11,2	1,9	1,6	3,4	0,9	11,3	1,6	100,0
AL032	Fier	41,4	24,0	5,3	11,3	1,3	2,1	4,0	2,6	7,0	1,1	100,0
AL033	Gjirokastër	31,2	8,3	8,4	20,8	2,8	3,9	4,6	2,0	15,3	2,6	100,0
AL034	Korçë	41,9	8,8	8,3	14,0	1,8	3,0	5,2	1,7	12,8	2,4	100,0
AL035	Vlorë	25,0	13,7	11,3	18,7	1,9	3,1	8,9	2,8	12,7	2,0	100,0


*Vlerësimi për vitin 2015 bazohet në të dhëna gjysëm finale

Fig.3 PBB për frymë sipas Qarqeve



NUTS 2
 Qark

PBB për frymë në mijë lekë




Shqipëria 496

* Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian*


Shënim: Kufijtë administrativë janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësive lokale.

Fig. 4 PBB me çmime korente sipas Qarqeve



NUTS 2
 Qark

PBB në miliardë lekë



* Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"

Shënim: Kufijtë administrativë janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësisë lokale.

Shënime Metodologjike

Ky publikim paraqet rezultatet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2015 në Republikën e Shqipërisë sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, si dhe degëve të ekonomisë sipas nomenklaturës NVE Rev2.

Llogaritë Kombëtare Rajonale bazohen në metodologjinë ESA 2010, kryesisht te Kapitulli13, duke marrë si bazë vlerësimet më të fundit të Llogarive Kombëtare Vjetore të publikuara më 31 Maj 2017, në mënyrë që të ruhet konsistenca e këtyre treguesve.

Informacioni më i detajuar rreth Llogarive Kombëtare Rajonale (2010 - 2015) mbi treguesit rajonalë mund ta gjeni në linkun më poshtë.

<http://www.instat.gov.al/al/themes/llogarit%C3%AB-kombetare.aspx?tab=tabs-5>

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e treguesve rajonalë mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare rajonale. Përditësimet e klasifikimeve bëhen që treguesit ekonomikë rajonalë të jenë më të dobishëm për përdoruesit, në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe të përmirësojnë krahasueshmërinë e të dhënave midis rajoneve dhe vendeve anëtare të BE-së bazuar në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian.

Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente, pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Ndryshimet në vlerësimet e Llogarive Kombëtare Vjetore kanë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji. INSTAT ka bërë një ndryshim cilësor në zhvillimin e metodave në vlerësimin e VSHB-së rajonale për ndarjen e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë kryesore në një apo më shumë rajone.

Në lidhje me metodologjinë e përdorur konsultohuni me materialin: “Metodologjia e Llogarive Rajonale në Shqipëri” në adresën e mëposhtme: http://www.instat.gov.al/media/251599/manual_metodologjik.pdf

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare Rajonale janë:

- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat (NUTS) është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbliidhen dhe përpunohen, statistikat rajonale evropiane.

Standardi i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard-PPS) është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatet (treguesit) vlerësuar me çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit i PBB-së për frymë i shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse (PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e Bashkimit Evropian (BE28=100).

Ju lutem vini re se indeksi i shprehur në PPS përdoret për krahasime midis vendeve sesa për krahasime në termat e serive kohore. Për informacione të mëtejshme mbi koeficientët e PPS ndiqni adresën e mëposhtme: <http://ec.europa.eu/eurostat/web/purchasing-power-parities/data/database>